



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE INVESTIMEVE TE HUAJA

Nr. 10832 / 4

Vlorë, më: 28 . 09 2022

DËGJESË PUBLIKE

Mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 si dhe planifikimi për Projekt Buxhetin e vitit 2023 për Bashkinë Vlorë

RAJONI 3

Data 15.09.2022: ora 13.00

Pjesëmarrës: Banorë dhe përfaqësues të komunitetit, Drejtore të Administratës dhe Institucionit të Bashkisë Vlorë, shoqëri civile. (listëprezenca bashkangjitur).

Manuela Prifti-Kryetare e Rajonit 3: Ju falenderoj për pjesëmarrjen. Jemi mbledhur për konsultimet për projekt buxhetin e vitit 2023 si dhe programin afatmesëm 2023-2025.

Pastrimi është përmirësuar dhe dua të falenderoj për këtë gjë bashkinë.

Daut Zeraj: Sipas ligjit për konsultimin e publikut dhe urdhrin e ministrit të Financave jemi mbledhur për të bërë konsultimin e publikut për programin AM të buxhetit 2023-2025, si dhe projekt buxhetin e 2025. Ky është takimi i parë me banorët e rajonit 3.

Disa nga treguesit kryesorë: struktura për sa i përket numrit të personelit s'do ketë ndryshime. S'do ketë rritje të taksave dhe tatimeve.

Viti 2022 ka patur vështirësi edhe për shkak të rritjeve të cmimeve. Janë realizuar deri tani rreth 70% e shpenzimeve. Rritja e buxhetit nuk do të jetë e lartë por modeste. Përqëndrimet do të jenë në investime në infrastrukturë. Pastrimi do të ketë më shumë fonde.

Në 2024 do të ketë rritje rreth 21% ndërsa në vitin 2025 do të ketë rritje rreth 35%.

Investimet në vitin 2022 të parashikuara rreth 73 milion për vitin 2024 do të jenë 79 milion ndërsa në vitin 2025 rreth 110 milion.

Për sektorin e arsimit parashikohen rritje në investime. Konkretisht për vitin 2022 do të jenë 25 milion, Për vitin 2024 janë parashikuar 40 milion dhe për vitin 2025 janë parashikuar 46 milion. Do të shikohen bashkëfinancimet me Ministrinë dhe qeverinë.

Për Rajonin 3 prioritet do të ketë:

Rikonstruksioni i shkollës Lef Sallata,

Rikonstruksioni i Pallatit të Kulturës si dhe një listë me objektet të parashikuara në programin buxhetor afatmesëm . Si në çdo njësi e rajon do të dalin prioritetet dhe do të kalojnë për rivlerësim.

Qytetari : Lagja Pavaresia, Rr. Kosova e kam shtruar me çakell vetë. Kur do shtrohet rruga?

Manuela Prifti: Eshte parashikuar. Gjithashtu edhe lagja 29 Nentori. Sistemi i shtyllave dhe ndriçimi në rrugën Albano dhe Romina.

Daut Zeraj: Këto janë me kosto të ulët dhe do shikohen për tu realizuar.

Qytetari : Sa përqind në zë, kalon për mirëmbajtje dhe për investimet që janë bërë pas dëmtimeve që kanë lënë pas projektet me dëmtime të mëdha? Ka nevojë për mjedis të gjelbëruar në bashkëpunim me biznes, hapësirat publike. Në një projekt të përbashkët me bashkinë do bëjmë një plan veprimi në Zverec, ekonomizimi për shpendët.

Qytetari : Kontrolli i ujit të pijshëm, shtyllat duhen nderruar, ka derdhje te tubacioneve ne anë të trotuarit. Dritat duhen zëvendësuar. Identifikimi i pikave të zonave mbledhëse të grumbullimit të mbetjeve urbane. Duhet fiksuar me numra për secilën zonë dhe orientim me tabela sqaruese.

Qytetari : Përgjatë bulevardit, koshat e vendosur janë konsumuar dhe duhen zëvendësuar e shtuar si numër. Nuk janë funksional, ka fond për ti riparuar?


Daut Zeraj: Buxheti është I limituar. Janë planifikuar rritje deri në 15% e investimeve për rrugë e trotuare. 10% për shërbime publike, 13% për shërbim pastrimi, dhe të tjera 15%-17% për administratën, dhe shpenzime të tjera për shërbime dekor, varreza, ndricimi, sport, kultura, teatri, arsimi etj.

Janë shume shpenzime shërbime dhe shpenzime që duhen të mbulohen të cilat nuk duken por realizohen.

Manuela Prifti: Ju falenderoj për pjesëmarrjen!

Hartoi

Albana Naçi


Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Bashkia Vlorë

